



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN
01.01.2022 DERI 30.06.2022, BASHKIA MALIQ”**

Tiranë 2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”



PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE	4
I/1. Hyrje.....	4
I/2. Objekti i Auditimit	4
I/3. Qëllimi i Auditimit	4
I/4. Metodologjia e Auditimit.....	4
I/5. Konkluzioni.....	5
II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË BASHKINË MALIQ.....	5
III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:	14



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

I. PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 370, datë 19.05.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme”, në ambientet e Bashkisë Maliq, më datë 22.05.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Zj. E. K. dhe Zj. S. J., në prezencë të përfaqësuesit të Institucionit të audituar Z. G. F., Zj. A. M., Zj. E. J. dhe Zj. A. Sh..

I/1. Hyrje

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 22.05.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar” të ushtruar në Bashkinë Maliq, sipas programit të auditimit nr. 370 prot., datë 19.04.2023, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. E. K., përgjegjëse e grupit;
2. S. J., anëtare.

Auditimi ka filluar më datë 24.04.2023.

Auditimi ka përfunduar më datë 26.05.2023.

Ky auditim është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe Udhëzimin e Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH”.

I/2. Objekti i Auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

I/3. Qëllimi i Auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e Auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësisë të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni

Nga përfundimi i punës në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekteve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH^{ja}, rezulton se:

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Maliq me shkresën nr. 56/7 prot., datë 16.05.2022. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezulton se nga Bashkia Maliq kanë filluar të merren disa masa lidhur me zbatimin e 8 rekomandimeve organizative, 4 masa për të ardhura të munguara dhe 5 masa disiplinore të lëna në total të cilat janë pranuar nga Bashkia Maliq.

Masa organizative

Nga 8 masa organizative, janë zbatuar 4 rekomandime, 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe 1 rekomandim nuk është zbatuar.

Masa për uljen e borxhit tatimor

Nga 4 masa për uljen e borxhit tatimor, 1 rekomandim është zbatuar dhe 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht.

Masa Disiplinore pika D

Nga 5 masa disiplinore të lënë, janë zbatuar rekomandimet për të 5 punonjësit.

Në përfundim rezulton se:

- Janë zbatuar gjithsej 10, 4 rekomandime organizative, përkatësisht 1.1, 2.1, 4.1 dhe 8.1, 1 rekomandim për uljen e borxhit tatimor, përkatësisht 2.1 dhe 5 rekomandime disiplinore;
- Janë zbatuar pjesërisht 6 rekomandime, 3 rekomandime organizative përkatësisht, 5.1, 6.1 dhe 7.1 dhe 3 rekomandime për uljen e borxhit tatimor përkatësisht, 1.1, 3.1 dhe 4.1;
- Nuk është zbatuar 1 rekomandim organizativ, përkatësisht, 3.1.

Nga sa shikohet niveli i zbatimit të rekomandimeve është në nivelin 59 % si numër dhe 24 % si vlerë, gjë e cila tregon se nga subjekti është vlerësuar procesi i zbatimit të rekomandimeve, por duhet të përqendrohet akoma më shumë në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, në arkëtimin e vlerave të paarkëtuara, kjo për të eliminuar kalimin e afateve ligjore të kërkimit të vlerave, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË BASHKINË MALIQ

1. Auditimi i fundit në Bashkinë Maliq

Auditimi i fundit në Bashkinë Maliq është kryer në vitin 2022 për periudhën 01.01.2020-31.12.2021, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 56/7 prot., datë 16.05.2022. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 8 masa organizative, pranuar nga subjekti;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

- 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara, në vlerën 89,240,499 lekë, pranuar nga subjekti;
- 5 masa disiplinore, pranuar nga subjekti.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j, Bashkia Maliq duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Maliq për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 56/7 prot., datë 16.05.2022 **nuk ka kthyer përgjigje** në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditës, por rezulton se është hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit me Urdhër nr. 245, datë 25.05.2022.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës nr. 56/7 prot., datë 16.05.2022, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”. Sipas verifikimit Bashkia Maliq **nuk ka kthyer përgjigje** në KLSH.

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Maliq ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 56/7 prot., datë 16.05.2022, por **nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

5. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Bashkinë Maliq Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

Masa organizative

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Maliq 8 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurën e ngritjes dhe funksionimit të NJAB u konstatua se, Njësia e Auditimit të brendshëm në bashki ka funksionuar me strukturë në nivel sektori me 3 auditues, nga të cilët 2 janë të certifikuar ku përgjegjësi është i certifikuar në vitin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

2008, një specialist është certifikuar në vitin 2021 ndërsa një specialist është i pa certifikuar, veprim në mospërputhje me neni 10, ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pika 3, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njesisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin publik”.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Maliq të marr masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të organizohet dhe të funksionojë me 3 punonjës të certifikuar kërkesë e parashikuar në kriteret për krijimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik.

Menjëherë.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Maliq me Urdhër nr. 605, datë 07.11.2022 ka emëruar një specialist Auditues i cili është në periudhë prove dhe certifikim, si dhe kanë marrë certifikatë 2 punonjës me numër regjistri 0249 dhe 2024.

Rekomandimi është zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria Financës, Bashkia Maliq deri më datë 31.12.2021, nuk ka likuiduar detyrime në vlerën gjithsej 60,126,055 lekë, (për fatura të mbërritura dhe që ju ka kaluar afati 60 ditore për likuidim në 16 raste në vlerën gjithsej 57,188,085 lekë dhe vendime gjykate të cilët i përkasin vitit 2020 e para në vlerën 2,970,749 lekë), veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48 dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit" neni 101.

2.1.Rekomandimi: Drejtoria Financës, për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën **60,126,055 lekë**, sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.

Menjëherë.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria Financës, ka hartuar grafikun për shlyerjen e detyrimeve, dhe pagesat janë bërë me Urdhër Shpenzimet nr. 48, 51, 52, 53, 169, 181, 167, 168, 129, 54, 259, 448, 20, 262, 313, 449, 704, 55, 255, 394, 451, 57, 452, 705, 706, 44, 46, 829, 828, 120, 160, 121, 267, 119, 159, 268, 119, 159, 268, nga data 19.01.2022 - 22.11.2022, për vlerën totale të detyrimit.

Rekomandimi është zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu **për vitin 2020**, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore dhe ato të trashëguara të planifikuar gjithsej në vlerën 303,661 mijë lekë në buxhetin fillestar, janë kryer shpenzime sipas realizimit faktik në vlerën 105,585 mijë lekë duke mos realizuar shpenzimet në vlerën **198,076 mijë lekë** (Paga dhe sigurime shoqërore, në vlerën 11,505 mijë lekë, Shpenzime operative, në vlerën 44,942 mijë lekë dhe Investime, në vlerën 131,991 mijë lekë). **Për vitin 2021**, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore dhe ato të trashëguara të planifikuar gjithsej në vlerën 307,663 në buxhetin fillestar, janë kryer shpenzime sipas realizimit faktik 124,261 mijë lekë duke mos realizuar shpenzimet në vlerën **183,402 mijë lekë**, (Paga, në vlerën 3,604 mijë lekë, Shpenzime operative, në vlerën 42,190 mijë lekë dhe Investime, në vlerën 133,958 mijë lekë), veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

3.1.Rekomandimi: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Maliq të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Në vazhdimësi.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Maliq nuk ka bërë analizë për zbatimin e rekomandimit dhe vazhdon të ketë diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit për vitin 2022, pasi planifikimi i buxhetit është në vlerë 1,565,775 mijë lekë dhe nga këto është realizuar vlera 1,340,304 mijë lekë me një diferencë 225,470 mijë lekë duke përfshirë fondet e kushtëzuara në vlerën 31,720 mijë lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, konstatohet se llogaria 202 “*Studime dhe projekte*”, është mbajtur në bilanc si llogari më vete në vlerën 49,300,043 lekë, pavarësisht faktit që disa nga këto studime e projekte i përkasin investimeve për 193 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim, në vlerën prej 45,835,955 lekë, të cilat nuk janë sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, kjo ka sjellë paraqitjen e AAM më pak sipas llogarive 211 “*Pyje, Plantacione*”, për vlerën 381,000 lekë, 212 “*Ndërtesa konstruksione*”, për vlerën 13,531,611 lekë dhe 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, në vlerën 30,687,344 lekë, për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk e pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e AAM, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “*Studime e kërkime*”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën **45,835,955 lekë për 193 projekte** dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara, si pjesë e kostos së tyre, në llogaritë 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 381,000 lekë, 212 “*Ndërtesa konstruksione*” në vlerën 13,531,611 lekë dhe 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” në vlerën 30,687,344 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021.

4.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financës, ka bërë sistemimet në llogarinë 202 “*Studime e kërkime*”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 45,835,955 lekë, si sistemimi i llogarisë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” në vlerën 30,687,344 lekë.

Rekomandimi është zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga 356 objekte inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 211 “*Pyje plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, në vlerën 2,822,441,983 lekë, nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

Bashkia Maliq për 36 objekte janë pajisur me titull pronësie, ndërsa për 16 objekte është në proces regjistrimi dhe për **304 objekte inventari, nuk posedon titull pronësie**, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2.

Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

5.1.Rekomandimi: Bashkia Maliq duhet të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Korçë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Në vijimësi.

5.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Maliq, ka vazhduar punën duke përgatitur dokumentacionin për regjistrimin e pronave të paluajtshme publike, shtetërore nga ish-komunat dhe aktualisht ka aplikuar vetëm për 118 prona në total, nga të cilat për 82 prej tyre janë pajisur me certifikatë deri në datë 02.03.2023 dhe 36 janë në proces shqyrtimi nga ASHK Korçë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet “**vlerën reale**” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Maliq, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarit të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” për 31 objekte (ndërtesa qendra shëndetësore, shkolla, etj) variojnë nga 1,000 lekë deri në 99,000 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli IV “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”.

6.1.Rekomandimi: Bashkia Maliq duhet të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi”.

Në vijimësi

6.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Maliq, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e PKZht, kanë realizuar mbledhjen për diskutimin e procedurave ligjore që duhet të ndiqen nga Bashkia Maliq për vlerësimin/rivlerësimin e pronave publike dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka dërguar kërkesë Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe prokurimeve publike me nr. 81 prot., datë 21.03.2023, por nuk janë rivlerësuar aktivet.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se nga 4113 prona në total, një pjesë e konsiderueshme e tyre prej 3757 pronash, sipas përshkrimit analitik në pasqyrën Aneks nr. 3/8 bashkëlidhur, nuk janë regjistruar në kontabilitet dhe Pasqyrën e Pozicionit Financiar “Aktivet afatgjata material”, pasi sipas inventarëve të trashëguar nga ish-Komunat sot Njësitë Administrative, janë paraqitur vetëm në sasi pa vlerë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli IV “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”.

7.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Maliq të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes, së pari nëpërmjet parashtrimit të të gjithë problematikës në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre, si dhe të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të Bashkisë Maliq, por nuk kanë të përcaktuar vlerën respektive, me qëllim vlerësimin e tyre dhe paraqitjen në Pasqyrat financiare të vitit 2021.

Në vijimësi

7.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Maliq, ka vazhduar punën duke përgatitur dokumentacionin për regjistrimin e pronave të paluajtshme publike, shtetërore nga ish-komunat, për 82 prej tyre janë pajisur me certifikatë deri në datë 02.03.2023 dhe 36 janë në proces shqyrtimi nga ASHK Korçë. Si dhe është diskutuar në mbledhjen e GMS në datë 25.05.2022.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave për detyrimet ndaj subjekteve të kryera në vitin 2021, u konstatua se disa fatura të paguara gjatë vitit 2021 për shërbime nga të tretët që i përkasin vitit 2020, nuk janë kontabilizuar si detyrim i lindur në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për **5 raste në vlerën 25,352,228 lekë**. Moskryerja e veprimeve kontabël me faturat e mbërritura për blerje mallrash e shërbimesh dhe kryerje investimesh e si rrjedhojë mos përfshirja e vlerës së detyrimeve që lindin prej tyre dhe të tjera në bilancin vitit ushtrimor, ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale të faturave të pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor 2020, për vlerën **25,352,228 lekë**, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2020 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve, veprime në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32. Aneksi I “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3/c.d “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Maliq, në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit, të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.

Në vijimësi

8.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financës Bashkia Maliq me shkresën nr. 1856 prot., datë 31.03.2022 ka dërguar pasqyrat financiare vjetore të vitit 2021, Degës së Thesarit Korçë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

dhe nga llogaria 85 “Rezultat i Veprimtarisë Ushtrimore”, është pakësuar për detyrimet e prapambetura dhe të konstatuara në llogarinë 401 dhe 467 për detyrimet e vendimeve gjyqësore.

Rekomandimi është zbatuar

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara.

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Maliq, 4 për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara në vlerën **89,240,499 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Maliq, konstatohet se, në fund të periudhës janë gjithsej debitorë **154** subjekte në vlerën **3,742,487 lekë** dhe **20265** familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerë **69,372,959 lekë**, edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 151 subjekte debitorë në vlerën 3,742,487 lekë, janë aktiv 118 subjekte ose 78 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, në vlerën 2,971,846 lekë ose 79 % e vlerës së debitorëve.

-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Maliq, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën **73,115,446 lekë**.

Menjëherë

1.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Maliq, Drejtoria e të Ardhurave, ka arkëtuar vlerën 900,544 lekë për 23 subjekte të cilët kanë paguar nga muaji Mars 2022 e në vijim, si dhe kanë paguar 4050 familje në vlerën 16,658,839 lekë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të pajisjes me Autorizim/Licenca të subjekteve që kryejnë tregti me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë u konstatua se subjekti “D. A.” shpk, nuk ka likuiduar detyrimin për Autorizimin lëshuar në datë 01.02.2019, për vlerën **700,000 lekë**, me pasojë **mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Maliq**, veprime në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kap II, pika 1; germa “b” dhe pika 9.

2.1.Rekomandimi: Bashkia Maliq, Drejtoria të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga subjekti “D. A.” të vlerës **700,000 lekë**, duke i njoftuar për detyrimin që ka ndaj bashkisë.

Menjëherë

2.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Maliq, Drejtoria të Ardhurave, ka njoftuar subjektin me shkresë nr. 5499 prot., datë 09.11.2020, dhe është bërë arkëtimi i vlerës totale në datat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

23.03.2022 me vlerë 200,000 lekë, në datë 08.04.2022 me vlerë 200,000 lekë dhe në datë 11.04.2022 me vlerë 300,000 lekë.

Rekomandimi është zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se subjekti “A. K.” nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2020 dhe 2021, për kontratën nr. 4834 Rep, nr. 3269 Kol, datë 26.07.2017 për shfrytëzim të fondit pyjorë të një sipërfaqe prej 0.15 ha për vendosjen e tubacioneve në gjatësinë 1.275 km, **në vlerën 448,800 lekë**, subjekti “E. V.” nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2021, për kontratën nr.3439, datë 19.06.2018 për shfrytëzim fondi pyjorë për sipërfaqe 2.5511 ha ose sipërfaqe në përdorim për shtrirje tubacioni në gjatësi 6.852 km, **në vlerën 1,178,940 lekë** dhe subjekti “Th. K.” nuk ka likuiduar detyrimet për kontratën nr. 1706 Rep, nr. 2052 Kol, datë 01.10.2010 për shfrytëzim të tregut të fruta-perimeve në Nj/Administrative Pirg me sipërfaqe ndërtese prej 310 m², **në vlerën 781,899 lekë** që janë detyrime për vitet 2018 e para, **gjithsej në vlerën 2,409,639 lekë**, duke sjellë të **ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Maliq**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, germa “g”.

3.1.Rekomandimi: Bashkia Maliq, Drejtoria të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga subjektet të **vlerës 2,409,639 lekë**, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë.

Menjëherë

3.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Maliq, Drejtoria të Ardhurave ka njoftuar subjektin me shkresë nr. 4216 prot., datë 02.08.2021 dhe nr. 4159 prot., datë 29.07.2021 për kryerje pagese, si dhe ka ngritur kërkesë padi në datë 11.10.2022, për zgjidhjen e kontratës nr. 4834 rep dhe nr. 3269 kol, datë 26.07.2017 midis Bashkisë Maliq dhe Shoqërisë, detyrimin e palës për lirim dhe objektit dhe shpërblimin e dëmit në shumën 448,800 lekë bashkë me kamatvonesat. Nga subjekti “A. K.” është shlyer me datë 27.10.2022 vlera 224,000 lekë.

Nga subjekti “E. V.” është paguar shumën prej 1,178,940 lekë në datë 07.04.2022. Për subjekti “Th. K.” i cili nuk ka likuiduar detyrimet për kontratën nr. 1706 Rep, nr. 2052 Kol, datë 01.10.2010 për shfrytëzim të tregut të fruta-perimeve në Nj/Administrative Pirg, në vlerën 781,899 lekë. (Bashkia Maliq ka lidhur kontratën e sipër cituar me një afat nga 01.10.2010-30.09.2022, subjekti “Th. K.” ka bërë kërkesë për prishje kontrate në datë 29.03.2018. Gjatë kësaj kohe subjekti ka paguar një pjesë të detyrimit e për diferencën prej 781,899 lekë bashkia ka bërë kërkesë për ekzekutimin e detyrimit me shkresë nr. 4487/7 prot., datë 04.12.2018 bankës “P.” dhe pas bllokimit të logarisë me Urdhër 4487 prot., datë 15.11.2018, nga banka me shkresë “Kthim përgjigje”, me nr. OP-43762/1, datë 13.12.2018, ka arkëtuar vlerën 9,000 lekë).

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ALUIZNI Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Korçë. Konkretisht për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2021, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **327 persona** me vlerë **13,015,414 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Maliq, veprime në kundërshtim



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 3.

4.1.Rekomandimi: Bashkia Maliq nëpërmjet strukturave të saj, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **13,015,414 lekë ndajë 327 personave**, si rezultat i mos arkëtimit të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje (ish-ALUZNI-t).

Kryetari i Bashkisë Maliq nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t’i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Korçë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

4.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Maliq, janë bërë rinjoftime për të gjithë debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë me shkresat përkatëse nga Mars i vitit 2023 e deri në Prill të këtij viti, gjithsej janë arkëtuar për 69 subjekte në vlerën 2,388,141.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

Masa disiplinore

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Maliq, 5 masa *disiplinore*, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

D/I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:

Për të gjithë punonjësit me status të Nëpunësit Civil, trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe anekset bashkëlidhur, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Maliq që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor**, pranë Institucionit Bashkia Maliq, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2021, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore, mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; neni 58-“*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, për **5 (pesë) punonjës**, si më poshtë:

1. znj.A. M., me detyrë Drejtore Financës.

Për shkeljet e konstatuara: Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, për moskontabilizimin e disa faturave të paguara gjatë vitit 2021 për shërbime nga të tretët që i përkasin vitit 2020, në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në vlerën 25,352,228 lekë, mos pasqyrim i saktë në mbyllje të pasqyrave financiare të llogarisë 202 “*Studime dhe projekte*”, për 193 objekte të përfunduara dhe të



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

marra në dorëzim, në vlerën prej 45,835,955 lekë, të cilat nuk janë sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit.

2. *znj. J. G., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së të Ardhurave.*

3. *znj. A. Sh. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave.*

4. *znj. E. Ç. me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Njësive Administrative për vitin 2020 dhe aktualisht Përgjegjëse e Kontrollit të Biznesit.*

5. *z. M. H. me detyrë ish Përgjegjëse e Kontrollit të Biznesit për vitin 2020 dhe aktualisht Përgjegjës i Sektorit të Njësive Administrative.*

Për shkeljet e konstatuara: Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar dhe mos arkëtimin e debitorëve në vlerën totale 73,115,446 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Maliq për punonjësit e lartpërmendur është ngritur komisioni disiplinor me Urdhër nr. 266 - 270, datë 03.06.2022, është bërë njoftimi i nëpunësit civil për fillimin e ecurisë së disiplinore dhe pas kthimit të përgjigjes mbi shkeljet është marrë Vendimi nr. 1 - 5 datë 24.06.2022 “Mbi procedimin disiplinor të ngritur për nëpunësit”.

Rekomandimi është zbatuar

Përmbledhëse e Masave

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	8	8	4	3		1
Masa për uljen e borxhit tatimor	4	4	1	3		
Masa Disiplinore	5	5	5			

III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Maliq për Projekt Raportin e Auditimit “Për auditimin financiar” dërguar me shkresën nr. 56/7 prot., datë 16.05.2022 rezulton se subjekti i audituar **nuk ka respektuar** afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve, **nuk ka njoftuar** brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe **nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësive (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësive së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësive.

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Maliq për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 56/7 prot., datë 16.05.2022, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

1. Rekomandimi nr. 3.1: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Maliq të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë

2. Rekomandimi nr. 5.1: Bashkia Maliq duhet të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Korçë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlloraritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Në vijimësi

3. Rekomandimi nr. 6.1: Bashkia Maliq duhet të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi”.

Në vijimësi

4. Rekomandimi nr. 7.1: Titullari i Bashkisë Maliq të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes, së pari nëpërmjet parashtrimit të të gjithë problematikës në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre, si dhe të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të Bashkisë Maliq, por nuk kanë të përcaktuar vlerën respektive, me qëllim vlerësimin e tyre dhe paraqitjen në Pasqyrat financiare të vitit 2021.

Në vijimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Rekomandimi nr. 1.1: Bashkia Maliq, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën e mbetur **55,556,066** lekë.

Menjëherë

2. Rekomandimi nr. 3.1: Bashkia Maliq, Drejtoria të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga subjekti “Th. K.” të vlerës **781,899** lekë

Menjëherë

3. Rekomandimi nr. 4.1: Bashkia Maliq nëpërmjet strukturave të saj, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Maliq”

e mbetur prej **10,627,273 lekë ndajë 258 personave**, si rezultat i mos arkëtimit të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje (ish-ALUZNI-t).

Kryetari i Bashkisë Maliq nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t’i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Korçë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

Zbatimi i rekomandimeve për Bashkinë Maliq (Formulari nr. 12), në mënyrë tabelore paraqitet:

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike ose efekt negativ në buxhet ose të ardhura të munguara								
			Pranuar në numër	Zbatuar në numër	Zbatuar pjesërisht në numër	Pa zbatuar në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar/ apo proces zbatimi		Ne Proces Civil apo Penal në 000/lek	Pa zbatuar (Pa filluar procedura)	
							Nr. pers	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë	Nr. pers	Në 000/lekë		Nr. pers	Në 000/lekë
I	NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT														
1	Shfuqizim akti														
2	Përmirësim akti														
II	MASA ORGANIZATIVE (Gjithsej, Në vlerë)	8	8	4	3	1									
III	MASA SHPËRBLIM DËMI (Nga të cilat nuk janë kontabilizuar, ne Finance)														
IV	MASA DISIPLINORE (Nga të cilat nuk janë nxjerrë urdhrat, vendime) me status të nëpunësit civil	5	5	5											
V	MASA 3E Nga të cilat: Të ardhura të munguara	4	4	1	3		89,240,499		89,240,499		21,826,464	448,800			66,965,235
VI	Dhe të tjera masa nëse ka Gjoha APP	4	4	1	3		89,240,499		89,240,499		21,826,464	448,800			66,965,235

Për sa më sipër mbahet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

AUDITUESIT SHTETËRORË TË KLSH-së

E. K. (Përgjegjës grupi)

S. J.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

B. D.